

KOMUNA ARREN

KUKES

Address: ARREN KUKES, Albania

Tel/Fax ++355 689026661

PERSON FIZIK Ilir KICA

TIRANE

Adress: Rruga 'Nexho Konomi'; Banesa Nr 15 H 1 ; Tirana, Albania

Tel ++355682165575

K O N T R A T E

Sot ne daten 23/08/2014, nenshkruhet kjo Kontrate per realizimin e mbikqyrje punime ne objektin: "Rikonstruksion i Shkolles nentevjeçare Arren" ndermjet paleve:

- KOMUNA ARREN KUKES
qe me poshte do te emertohet Investitori, perfaqesuar nga Z. Ilir DOÇI ,
Kryetari i ketij Institucioni.
- PERSON FIZIK Ilir KICA, TIRANE qe me poshte do te emertohet Sipermarresi,
Mbikqyresi .

Te dy perfaqesuesit e paleve te cilesuar si me siper ne kete kontrate, deklarojne me vullnetin e tyre te lire se lidhin kete kontrate me kushtet qe vijojne:

Neni 1. OBJEKTI

Objekt i kesaj Kontrate do te jete : Mbikqyrja e punimeve ,mbajtja e dokumentacionit,provat sipas fazave dhe kontrolli i likujdimit te punimeve te kryera per objektin: : "Rikonstruksion i Shkolles nentevjeçare Arren".

Neni 2 . BAZA LIGJORE

Baza ligjore e kesaje kontrate eshte: Ligji Nr 8402, date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit"(me ndryshimet perkatese),UKM. Nr.3 date 15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit" dhe UKM Nr.2 Date. 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit" V.K.M Nr. 444, date 05.09.1994 "Per tarifat e studimit dhe projektimit,drejtimit te veprave te ndertimit" dhe Udhezimit te K.M Nr. 4, date 26.06.1995 "Per drejtimin dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit".

Neni 3. VLEFTA


Vlefte totale e kesaj Kontrate, eshte e shprehur ne leke, per vleren 490 000 (katerqind e nent-edhjete mije). leke

Neni 4. AFATI

- Fillimi ne23/08/2014
- Mbarimi ne perfundimin e punimeve ne objekt.

Neni 5. BURIMI EKONTRATES

Burim financiarimi jane fondet e buxhetit te shteti.



Neni 6. GJUHA

Gjuha e perdorur ne formulimin e kontrates dhe çdo dokumentacioni tjetër lidhur me te është gjuha shqipe.

Neni 7. KOMUNIKIMI

Komunikimi midis paleve nënshkruese të kesaj kontrate do të marrë vlerë ligjore vetëm kur ai të bëhet me shkrim dhe pasi të jetë dorëzuar.

Neni 8. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E SIPERMARRESIT

1. Te zbatoje me rigorozitet Ligjin Nr.8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit"(me ndryshimet perkatese),UKM. Nr.3 date 15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndertimit" dhe UKM Nr.2 Date. 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve të ndertimit"
2. Mbikqyresi duhet të qendrojë në objekt gjatë kohës që zhvillohen punimet. Ai duhet të informojë investitorin për gjendjen e punimeve.
3. Për çdo ndryshim në projekt ose në volume e preventivuar duhet të marrë miratimin me shkrim të investitorit.
4. Kërkon nga sipermarresi mbajtjen e dokumentacionit, pasqyrat e volumeve, proces-verbalet e punimeve të maskuara të cilat duhen të kryhen vetëm pas miratimit me shkrim nga drejtuesi i punimeve.
5. Kërkon nga sipermarresi të zbatohen detyrat që përmban kontrata, grafikun e zbatimit të punimeve, projektin specifikimet teknike dhe cilesite e materialeve të perdorura sipas kushteve teknike.
6. Mbikqyresi i punimeve mban përgjegjësi për shkeljen e kontrates dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 9. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E INVESTITORIT

Te krijojë kushte të përshtatshme për sipermarresin.

Neni 10. NDRYSHIMET DHE PRISHJA E KONTRATES

Çmimet e Kontrates do të jenë të pandryshueshme për të gjithë periudhën e zbatimit të sajë. Ndryshimet e çmimeve të punimeve gjatë periudhës së zbatimit të kontrates, nuk do të merren në konsideratë nga asnjëra palë.

Palet mund të bëjnë ndryshime ose shtesa në përmbajtjen e Kontrates për atë sa i lejon ligji dhe sa parashikohet në këtë Kontratë. Çdo ndryshim ose shtesë do të bëhet me shkrim. Format e tjera do të konsiderohen të pavlefshme.

Kontrata do të konsiderohet e prishur në rast se ajo perfundon e tillë me shkrim siç është rënë dakort midis paleve.

Neni 11. KUSHTE TE TJERA

Kontrata hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga të dy palet.

Palet nënshkruese të Kontrates nuk përgjigjen për kushtet e kesaj kontrate përsa kohë që veprojnë forca madhore, për të cilat palet janë të detyruara të njoftojnë njëra tjetren dhe të gociojnë për një zbatim doftë dhe pjesor të saj nëse kërkohet nga njëra palë. Do të shikohet "Force madhore" çdo ngjarje që ndodh jashtë vullnetit të Bleresit dhe që nuk mund të parashikohet.


ARGENT

MBIKQYRJE KOLAUDIM
ILIRIKA
1261 MKZ/97
ILIRIKA
2000
Baqe Z

Mosmarveshjet midis paleve do te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert do te zgjidhen nepermjet Gjykates rrethit Kukes.

Kjo kontrate eshte pergatitur ne kater kopje dhe ne gjuhen shqipe. Pasi u lexua nga te dy palet, u nenshkrua me vullnet te lire. Sejcila pale mer nga dy kopje.

PER INVESTITORIN



PER SIPERMARRESIN

MBIKQYRESI

/Ing. Ilir KICA /

